



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 6881/1 Prot.

Tiranë, më 1.12.2021

U D H Ë Z I M

Nr. 23, datë 1.12.2021

P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 10.06.2021, "PËR  
PROCEDURAT E PRANIMIT E TË EMËRIMIT TË MËSUESIT  
NË NJË VEND TË LIRË PUNE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE  
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PËR ADMINISTRIMIN  
E PORTALIT "MËSUES PËR SHQIPËRINË"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 10.06.2021, pas pikës 4 të Kreut 2, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

*"4/1. Nuk mund të aplikojnë për konkurrim për të punuar si mësues, pavarësisht faktit të rehabilitimit, të gjithë personat që:*

- a) janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve.*
- b) janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore."*

2. Shtojca 5 e udhëzimit zëvendësohet me shtojcën 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

MINISTRI

EVIS KUSHI



## SHTOJCA 5

### VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: \_\_\_\_\_

Datëlindja: \_\_\_\_\_

Vendlindja: \_\_\_\_\_

Dokumenti i identifikimit (Kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: \_\_\_\_\_

i/e padënuar

i/e dënuar

**Deklaroj me vullnetin tim të lirë se nuk kam qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore, apo i rehabilituar për këto vepra penale.**

Emër, mbiemër: \_\_\_\_\_ Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

*Autorizim:* Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

*Shënim.* Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.